



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Corectional Service
Drejtoria e Përgjithshme

Prishtinë: 04.06.2025

Duke u bazuar në nenin 53, paragraf 1 dhe 3 i Ligjit Nr.05 /L-031 për Proceduren e Përgjithëshme Administrative dhe Ligji Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës neni 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Anullohet vendimi nr. protokolli 438, datë: 11.04.2025 si dhe vendimi me nr. Protokolli 513, datë: 29.04.2025 me të cilët janë emëruar komisionet përzgjedhëse për pozitën Mbikëqyrës i Lartë dhe Mbikëqyrës.

II. Të gjitha veprimet e komisioneve përzgjedhëse sipas vendimeve të anuluar në pikën 1 të këtij vendimi janë të pa vlefshme dhe nuk prodhojnë asnjë pasojë juridike.

III. Konkursi i shpallur për pozitat Mbikëqyrës i Lartë dhe Mbikëqyrës mbetet në fuqi dhe procedura e gradimit vazhdon pas themelimit të Komisionit Përzgjedhës.

IV. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej tre (3) ditësh të bëjë propozimin për anëtarët e rinj të komisionit përzgjedhës.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Themelimi i komisioneve përzgjedhëse për procesin e gradimit për pozitën Mbikëqyrës i Lartë dhe Mbikëqyrës është bërë duke u bazuar në vendimin A.nr. 159/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili në procedurë të ankimit ka obliguar Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të formoj komision të ri për gradim. Pas formimit të komisionit dhe zhvillimit të procesit të gradimit është evidentuar një lëshim në përbërjen e komisioneve të gradimit sipas nenit 51, paragraf 3 të ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, pasi që kryesuese dhe një anëtarë i komisionit nuk e kanë kaluar ende periudhën provuese pas themelimit të marrëdhënies së punës në pozitat udhëheqës, grada IV, andaj me qëllim të evitimit të shkeljeve të dispozitave ligjore të cekura me lartë u vendos si në dispozitiv.

Vendimi ju dërgohet:

1. Njesisë së Burimeve Njerëzore të SHKK-së;
2. Arkivit të SHKK-së.


Drejtör i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës